

VENDIM
Nr.1240, datë 16.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i tretë i pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pagesa e aftësisë së kufizuar për të verbërit dhe kujdestarët e tyre, bëhet nga shërbimet bankare që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi, ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha